



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Komisioni për Buxhet dhe Financa
Mbledhja nr. 101 /13
Prishtinë, më 03.04.2013, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadergjona, Naser Osmani, Jelena Bontic, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Sevdije Lama dhe Xhevdet Neziraj.

Munguan: Latif Gashi, Albana Fetoshi dhe Duda Balje.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Luljetë Krasniqi, Dashurije Canolli.

Gjithashtu ishin të pranishëm: Ramadan Islami dhe Rejhane Zylfijaj nga GIZ.

Mbledhjen e kryesoi: Safete Hadergjona- kryetare e Komisionit

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 27.03.2013;**
3. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit me amandamentet e Komisionit Funkcional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-134 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi me amandamentet e Komisionit Funkcional për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;**
5. **Të ndryshme.**

1. **Miratimi i rendit të ditës**

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur e Komisionit, dt. 27.03.2013

Kryetarja theksoi se procesverbali miratohet pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së

Kryetarja theksoi se është një projektligj i rëndësishëm që ka të bëjë me forcën e sigurisë. Në bazë të deklaratës së Ministrisë së Financave vërejmë se kemi disa implikime buxhetore, të cilat janë të përballueshme për buxhetin. Janë disa nene të ligjit të cilat i rregullojnë daljen e forcës së sigurisë jashtë Kosovës. Në ligj është e paraparë mundësia që kompensimet për shpenzimet e dërgimit të pjesëtarëve të FSK-së jashtë vendit të mund të kërkojnë të barten edhe nga vendi ku bëhet shërbimi.

Komisioni, njëzëri nxori këtë rekomandim

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-177 për dërgimin e Forcës së Sigurisë së Kosovës jashtë vendit me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr.04/L-134 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Kryetarja theksoi se nga analiza që i kemi bërë projektligjit nuk kemi vërejtur se përmban implikime buxhetore shtesë. Edhe Ministria e Financave e ka vlerësuar pa kosto shtesë buxhetore. Po ashtu as amendamentet nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

Komisioni, njëzëri e nxori këtë rekomandim

Rekomandim

Projektligji nr.04/L-134 për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi me amandamentet e Komisionit FunkSIONAL nuk përmbajnë implikime buxhetore shtesë.

5. Të ndryshme

5.1. Kryetarja njoftoi se Ligji për Odat e Profesionistëve shëndetësor ende nuk është amendamentuar në tërësi për shkak të mosharmonizimit të dy Ministrive. Sipas kërkesë së Komisionit, grupi punues do të vazhdojë punën dhe do del me rekomandime për miratim në Komision.

5.2. Kryetarja kërkoi nga grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për Prokurimin Publik të fillojë punën në monitorim, duke ditur që në plan të punës është paraparë të monitorohet edhe ligjit për lojërat e fatit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryesuesja e Komisionit

Safete HADERGJONAJ